

VENDIM
Nr.772, datë 16.11.2006

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË MJEDISEVE TË “DEPO DRITHI NR.2 (MAGAZINË), TË REZERVAVE TË SHTETIT, AGJENCIA LUNDËR”, NGA MINISTRIA E BRENDSHME KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, 15 e 16 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të mjediseve të “Depo drithi nr.2, të Rezervave të Shtetit, agjencia Lundër”, nga Ministria e Brendshme Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, sipas formularit dhe planimetrisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë, të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

3. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te vecanta)

Institucioni i Pushtetit Qendror: <u>DREJTORIA E PERGJITHSHME E REZERVAVE SHTETERORE</u>				Identifikoi: <u>Bardhyl Fasko Drejtor Dege</u> (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)			
Bashkia / Komuna: <u>FARKE, RRETHI TIRANE</u>				Supervizori: <u>Gavrosh Qatipi, Drejtor Drejtorise Teknike ne D.P.R.SH</u> (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)			
Fusha e perdorimit te Prones: <u>REZERVE SHTETI</u>				Aprovoi: <u>SOKOL HAJRO DREJTOR I PERGJITHSEM</u> (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)			

A			B			C				
Nr.	Zona Kadastrale / Indeks i Hartes	Nr. Pasurise	Emertesa e Prones / Vend ndodhja / Shtrirja Gjeografike	Komponentet perberes te Prones	Adresa/Vend ndodhja e komponenteve perberes	Pemasat e Prones ne m ² ose m ³	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni/Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni/Enti perdorues / Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te vecanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
				MAGAZINE nr 1, 1 kat çati eternit	Brenda territorit	484.2	Per Rezerve Shteti	D.P.R.SH	D.R.Tirane	ME QERA Tatum-Taksave
				DEPO DRITHI nr 2 1 kat, çati tregulie	Brenda territorit	960	Rezerve Shteti	D.P.R.SH	D.R.Tirane	
				DEPO nr 3, 1 kat me çati eternit+tegulli	Brenda territorit	435	Per mallra rezerve	D.P.R.SH	D.R.Tirane	
				DEPO nr 4, 1 kat çati eterniti	Brenda territorit	960	Per Rezerve Shteti	D.P.R.SH	D.R.Tirane	
				DEPO nr 5, 1 kat beton	Brenda territorit	960	Mallra sekuestro	D.P.R.SH	D.R.Tirane	
				DEPO nr 6, 1 kat me çati tregulie+llamarine	Brenda territorit	960	Mallra ne ruatje	D.P.R.SH	D.R.Tirane	Me qera 200 m katror Ford Ndahkombetari
				DEPO HELMESH 1 kat harkore	Brenda territorit	271.53	Per malina	D.P.R.SH	D.R.Tirane	

Planimetria e Depos Nr. 2 ne Lunder

61



